## Çfarë është tuberkulozi?

**Tuberkulozi është një sëmundje infektive e rëndë dhe ngjitëse, e cila shkaktohet nga bakteret.**

Për një shërim të shpejtë është më rëndësi një dallim (diagnostikim) i hershëm dhe një trajtim i plotë.

Tuberkulozi mund të prekë organe të ndryshme të trupit të njeriut. Më shpesh preken mushkëritë.

Përveç mushkërive mund të preken edhe organe të tjera, p.sh. nyjat limfatike, veshkat dhe artikulacionet, shtylla kurrizore dhe sistemi nervor qendror.




Literaturverzeichnis:

- Bayerisches Landesamt für Gesundheit und Lebensmittelsicherheit. Erlangen. Tuberkulose. 2016. ( www.lgl.bayern.de/gesundheit/infektionsschutz/infektionskrankheiten_a_z/tuberkulose/ )
- Bundeszentrale für gesundheitliche Aufklärung. Tuberkulose. Köln. 2016 ( www.infektionsschutz.de/erregersteckbriefe/tuberkulose/ )
- Robert-Koch-Institut. Berlin. 2016. Tuberkulose. ( www.rki.de/DE/Content/InfAZ/T/Tuberkulose/Tuberkulose.html )


Bayern.
Die Zukunft.

BAYERN DIREKT ist Ihr direkter Draht zur Bayerischen Staatsregierung.

Unter Telefon 089 12 22 20 oder per E-Mail unter direkt@bayern.de erhalten Sie Informationsmaterial, Broschüren, Auskunft zu aktuellen Themen und Internetquellen sowie Hinweise zu Behörden, zuständigen Stellen und Ansprechpartnern bei der Bayerischen Staatsregierung.


Herausgeber: Bayerisches Landesamt für Gesundheit und Lebensmittelsicherheit
Eggenreuther Weg 43, 91058 Erlangen
Internet: www.lgl.bayern.de
E-Mail: poststelle@lgl.bayern.de
Telefon: 09131 6808-0
Telefax: 09131 6808-2102

Bildnachweis: panthermedia.net/Remains; thinkstock.com/mantosh; thinkstock.com/didesign021
Gestaltung: CMS – Cross Media Solutions GmbH
Druck: Druckerei Schmerbeck, Tiefenbach
Stand: August 2017
Artikelnummer: stmgp_gesund_061


© LGL, alle Rechte vorbehalten

Hinweis: Diese Druckschrift wird kostenlos im Rahmen der Öffentlichkeitsarbeit der Bayerischen Staatsregierung herausgegeben. Sie darf weder von den Parteien noch von Wahlwerbern oder Wahlhelfern im Zeitraum von fünf Monaten vor einer Wahl zum Zweck der Wahlwerbung verwendet werden. Dies gilt für Landtags-, Bundestags-, Kommunal- und Europawahlen. Missbräuchlich ist während dieser Zeit insbesondere die Verteilung auf Wahlveranstaltungen, an Informationsständen der Parteien sowie das Einlegen, Aufdrucken und Aufkleben parteipolitischer Informationen oder Werbemittel. Untersagt ist gleichfalls die Weitergabe an Dritte zum Zweck der Wahlwerbung. Auch ohne zeitlichen Bezug zu einer bevorstehenden Wahl darf die Druckschrift nicht in einer Weise verwendet werden, die als Parteinahme der Staatsregierung zugunsten einzelner politischer Gruppen verstanden werden könnte. Den Parteien ist es gestattet, die Druckschrift zur Unterrichtung ihrer eigenen Mitglieder zu verwenden. Bei publizistischer Verwertung – auch von Teilen – Angabe der Quelle und Übersendung eines Belegexemplars erbeten.
Das Werk ist urheberrechtlich geschützt. Alle Rechte sind vorbehalten. Die Broschüre wird kostenlos abgegeben, jede entgeltliche Weitergabe ist untersagt. Diese Broschüre wurde mit großer Sorgfalt zusammengestellt. Eine Gewähr für die Richtigkeit und Vollständigkeit kann dennoch nicht übernommen werden. Für die Inhalte fremder Internetangebote sind wir nicht verantwortlich.



Bayerisches Landesamt für
Gesundheit und Lebensmittelsicherheit




# Tuberkulozi,

## dallimi dhe trajtimi në kohë i tij

**Informacion i Zyrës Shëndetësore**

**Gjuha Gjerm/Albanisch**

LGL

www.lgl.bayern.de

## Cilat janë simptomat e mundshme?

- Kollë afatgjatë, me raste me nxjerrje gjaku
- Dhimbje gjatë frymëmarrjes
- Lodhje dhe rraskapitje
- Ethe
- Humbje e padëshirueshme në peshë
- Djersitje gjatë natës
- zmadhim i nyjave limfatike

## Kush është veçanërisht i rrezikuar?

- Foshnjat në gji dhe fëmijët e vegjël
- Njerëzit me sistem të dobët imuniteti, p.sh. nga sëmundje kronike (sëmundje tumorale, HIV) ose mungesë të ushqyerit.
- Njerëzit që kanë pasur kontakt në ambient të afërt me të sëmure me tuberkuloz (p.sh. rrethi familjar dhe shoqëror).
- Emigrante dhe emigrantë nga Afrika e Jugut, Evropa Lindore dhe Azia Qëndrore.
- Njerëzit që kanë qëndruar në një vend ku tuberkulozi shfaqet më shpesh se në Gjermani.
- Njerëzit që kanë qenë të sëmurë në të kaluarën me tuberkuloz.

## Si transmetohet tuberkulozi?

Personat me tuberkuloz në mushkëri janë ngjitës, pasi ata shpërndajnë baktere gjatë kollitjes ose teshtitjes. Njerëzit e tjerë mund t'i thithin pikat që shkaktare dhe të marrin sëmundjen ngjitëse. Nëse arrihet marrja e sëmundjes varet nga kohëzgjatja dhe niveli i kontaktit. Tuberkulozi, i cili nuk ka prekur mushkëritë, nuk është ngjitës nëpërmjet kontaktit normal.

## Cili është raporti që ekziston midis ngjitjes dhe shpërthimit të sëmundjes?

Jo çdo kontakt me baktere të tuberkulozit çon në sëmurje. Në shumicën e rasteve sëmundja nuk shpërthen, pasi sistemi i imunitetit kontrollon shkaktuesit e tuberkulozit pasi të jenë marrë në trup. Në këtë mënyrë, në dy vitet e para sëmuren vetëm rreth dhjetë për qind të njerëzve pas marrjes së baktereve në trup. Por, në varësi të moshës dhe gjendjes mbrojtëse, mund të ndodhë që sëmundja të shpërthejë pas disa muajsh ose edhe pas dekadave.



## Si diagnostikohet sëmundja?

Kur ka simptoma të tuberkulozit nevojitet një vizitë dhe ekzaminim mjekësor *i menjëhershëm.*

Një ekzaminim me rreze rentgen i mushkërive mund të japë udhëzime për një sëmundje tuberkulare. Përveç kësaj, në dispozicion është analiza e gjakut dhe analiza e lëkurës. Megjithatë, një diagnozë e sigurt mund të përcaktohet vetëm pas evidentimit të shkaktarëve të tuberkulozit nga material i përshtatshëm ekzaminimi (p.sh. nxjerrje).

## Si trajtohet tuberkulozi?

Tuberkulozi trajtohet me sukses nëpërmjet medikamenteve. Nëpërmjet një terapie me kohëzgjatje të mjaftueshme dhe marrjes së besueshme të medikamenteve, në shumicën e rasteve sëmundja mund të shërohet.

## Ku mund të gjej ndihmë?

Nëse dyshoni se jeni sëmurë me tuberkuloz, drejtojuni mjekut tuaj. Zyra Shëndetësore lokale ofron konsulencë falas.

**Informacione të mëtejshme gjeni edhe në internet:**

- Robert Koch-Institut: www.rki.de/tuberkulose
- Bayerisches Landesamt für Gesundheit und Lebensmittelsicherheit LGL (Zyra e Landit të Bavarisë për Shëndetësi dhe Siguri të Produkteve Ushqimore): www.lgl.bayern.de/gesundheit/infektionsschutz/infektionskrankheiten_a_z/tuberkulose/
- Deutsches Zentralkomitee zur Bekämpfung der Tuberkulose (DZK) (Komiteti Qëndror i Gjermanisë për Luftën kundër Tuberkulozit): www.dzk-tuberkulose.de
- ExplainTB online: Shpjegime në lidhje me tuberkulozin të bazuara në smartfon: www.explaintb.org